



KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 04.09.2019

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR PËR SHQYRTIMIN E KANDIDATURËS SË PROPOZUAR NGA KËSHILLI I MINISTRAVE PËR KOMISIONER PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, nenit 111, pika 4, të rregullores së Kuvendit dhe të nenit 33 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, ‘Për mbrojtjen e të dhënave personale’, në mbledhjen e datës 04.09.2019, në cilësinë e komisionit përgjegjës mori në shqyrtim Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 550, datë 31.07.2019, “Për propozimin Kuvendit të Shqipërisë të kandidaturës për Komisioner për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale” dhe zhvilloi seancë dëgjimore me kandidaturën e propozuar Z. Besnik Dervishi.

Në seancën dëgjimore të kandidatit, Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike shqyrtoi përmbushjen e kriterëve ligjore dhe meritën e kandidaturës referuar CV dhe pyetjeve të drejtëpërdrejta.

Nga shqyrtimi i CV së Z. Besnik Dervishi , rezultoi se Z. Dervishi i përmbush të gjitha kriteret ligjore pasi ai ka mbajtur pozicionin e Komisionerit për Informim me Vendimin e Kuvendit nr. 52, datë 24.07.2015, mandat 5-vjeçar i përfunduar në datën 24.07.2019.

Sipas përcaktimeve të nenit 35, të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Z. Dervishi plotëson kriteret për t’u zgjedhur në pozicionin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Z. Dervishi ka plotësuar formularin e vetëdeklarimit në përputhje me germën dh, pika 4, neni 5, i këtij ligji.

Në zbatim të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, kandidati ka plotësuar formularin e aplikimit për informim.

Rezultoj se kandidati i propozuar Z. Dervishi, nuk ka asnjë pengesë ligjore për të kandiduar për Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe nuk ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë dhe konfliktit të interesit të parashikuar në nenin 34, të ligjit nr. 9887 date 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Në përfundim të seancës dëgjimore dhe procesit të vlerësimit të përmbushjes së kriterëve ligjore dhe meritës së kandidaturës relatori e komisionit, u shpreh se kandidatura i plotëson kriteret ligjore e profesionale për t’u rizgjedhur në funksionin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke propozuar votimin e Z. Dervishi në seancë plenare.

Pas votimit në Kuvend, kandidati Z. Besnik Dervishi do të ushtojë mandat të 5 vjecar, në funksionin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

I. Përfundime

Në përfundim të mbledhjes, Komisioni e miratoi me votat pro të shumicës së anëtarëve të pranishëm në mbledhje propozimin e Këshillit të Ministrave dhe ia paraqet për miratim seancës plenare, sipas variantit që i bashkëlidhet këtij raporti.

RELATOR

Adnor SHAMETI

KRYETAR

Ulsi MANJA